



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Nr.1, TIRANË

Nr 1125 Prot

Tiranë më 27.10.2025

Lënda: *Njoftim për levizje paralele*

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; Ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; Udhëzimit nr. 759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publike të arsimit dhe formimit profesional", Ofruesi publik i AFP-së Qendra e Ofritit të Formimit Profesional Publik nr. 1 Tiranë,

Ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin Instruktur i kursit "Reception"-1 Person.

I. KRITERET E PËRGJITHSHME DHE KRITERET E POSAÇME

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Kritere të posaçme për Instruktur të praktikës profesionale:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin po aplikon;
- b) Të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.
- d) Aftësi të tjera nëse kërkohen.

II. DOKUMENTET E APLIKIMIT

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letërmotivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- Librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit publik të QPF-së, brenda datës 04.11.2025.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr.759, datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të insitucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit, i ndryshuar.

DREJTOR

Harëne MATA

